



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 31.01.2014

Nr. 0207-76

PËR: Begzad Sinani, Kryetar i Komunës së Kamenicës
Bajram Dërmaku, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË KAMENICËS, Nr. 01-01480, të pranuar me datën 17.01.2014.

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit me Nr. 01-01480, të datës 10.01.2014, të Kuvendit të Komunës së Kamenicës, konstaton se:

- Vendimi Nr. 01-01480 për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës është në kundërshtim me nenin 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 15.2 dhe 15.3 të Statutit të Komunës së Kamenicës.
- Njëkohësisht vendimi Nr. 01-01480 është edhe në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores MAPL Nr. 01/2013 për procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave, e cila e precizon se amendamenti, plotësimi ose shfuqizimi i një akti nënligjor të komunës bëhet nga akti i njëjtë nënligjor.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 81 pika 4 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës që të ndërmarrin veprime konkrete që në afat prej 30 ditësh të bëjë rishqyrtimin e Vendimit nr. 01-01480, të Kuvendit të Komunës së Kamenicës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqësve të Departamenteve
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 31.01.2014
br. 0207-76

Za: **Begzad Sinani**, Gradonačelnik opštine Kamenica
Bajram Dërmaku, Predsedavajući Skupštine opštine Kamenica

Predmet: **Zahtev o ponovnom razmatranju odluke Skupštine opštine Kamenica**
br. 01-01480, primljeno dana 17.01.2014.

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom br. 03/L-040,o lokalnoj samoupravi dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva , nakon razmatranja zakonitosti odlukeNr. 01-01480, dana 10.01.2014, Skupštine opštine Kamenica konstatuje da :

- Odluka br. 01-01480 o izmeni i dopuni statuta opštine je u suprotnosti sa članom 12.3 zakona o lokalnoj samoupravi i člana 15.2 i 15.3 Statuta opštine Kamenica .
- Istovremeno odluka br. 01-01480 je u suprotnosti sa članom 12 uredbe MALS-a br. 01/2013 o proceduri izrade i objavljivanja opštinskih akti , koja precizuje da amandamentacija , dopuna ili ukidanje jednog podzakonskog akta opštine se vrši sa istog podzakonskog akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , na osmovu člana 81 tačka 4 zakona o lokalnoj samoupravi *traži od strane Skupštine oppštine Kamenica* da preduzme konkretne akcije u roku od 30 dana da izvrši ponovno razmatranje odluke br. 01-1481, Skupštine opštine Kamenica .

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopija: *Besnik Osmani*, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVES GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarshtvo Lokalna Samouprava i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data
Datum
17.01.2014

№ i Lëndës	Shënimi	Vlera
027-26	2	

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVES
CENTRA PER SHËRBIM TË UYRTAREVE
CENTAR ZA DREJIGU GRADANA

Sb. 01 Nr. 1480
D. Br.
Nr. i faq. 2 Data: 17/01
Br. str. Datum: 2014
KAMENICEJA

KOMUNA E KAMENICËS
KRYETARI I KOMUNËS
02.Nr. _____, Më 10.01.2014

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L.-040 dhe nenit 10 dhe 15 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 10.01.2014, mori këtë

V E N D I M
MBI NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR.15 TË DATËS 31.05.2010

I

Neni 6 i Vendimit nr.15 i datës 31.05.2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Kamenicës 01 nr.005/2008, ndryshohet dhe bëhet:

- a) Drejtoria e Administratës së Përgjithshme,
- b) Drejtoria e Arsimit,
- c) Drejtoria e Financave dhe Buxhetit,
- d) Drejtoria e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Diasporës,
- e) Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor,
- f) Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë,
- g) Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
- h) Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit,
- i) Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- j) Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit,
- k) Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe

II

Me qëllim të funksionimit më efikas të administratës komunale, Kryetari i Komunës ka nxjerr propozim-vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.01, nr.15 të datës 31.05.2010 me të cilin është ndryshuar Statuti i Komunës 01.nr.005/26.09.2008, dhe atë:

1. shkronja c), e cila ka qenë: Drejtoria e Ekonomisë,Financave dhe Zhvillimit, plotësohet dhe ndryshohet me tekstin: Drejtoria e Financave dhe Buxhetit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Zhvillimit dhe Diasporës dhe

2. shkronja g) e cila ka qenë: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ambientit, ndryshohet dhe bëhet: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit.

Vendimi nuk ka implikime financiare, pasi që numri i drejtorive mbetet i njëjtë, por propozohet vetëm modifikimi i emërimit të tyre.

III

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 10.01.2014 e ka shqyrtuar propozim-vendimin dhe ka vendosur si në pikën I të këtij Vendimi.

IV

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës Me hyrjen e tij në fuqi pushojnë së vepruari pasojat juridike të nenit 6 të Vendimit nr. 15 të datës 31.05.2010.

V

Vendimi është pjesë përbërëse e Statutit të Komunës së Kamenicës dhe si i tillë do të inkorporohet në tërësinë fizike të tij.

VI

Me Vendimin të njoftohen: kryetari, kryesuesi i kuvendit, drejtorët e drejtorive komunale, Zyra Ligjore, Shërbime Profesional i Kuvendit dhe Qendra për Shërbime të Qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

